



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 11.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës: 08.05.2023, të parashtruar nga OE STUDIO HAPSIRA SHPK, adresa- Mati 1 - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Perzgjedhja e nje kompanie gjeodezike te licencuar per matjen gjeodezike per rrugen Haradin Bajrami dhe Shqiperia” me nr. të Prokurimit: 613-23-4330-2-3-6, nxjerr:

V E N D I M

I Hudhet poshtë si e jashtë aftatshme, kërkesa për ri-shqyrtim, e paraqitur me dt; 08.05.2023, nga OE OE STUDIO HAPSIRA SHPK, adresa- Mati 1 - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Perzgjedhja e nje kompanie gjeodezike te licencuar per matjen gjeodezike per rrugen Haradin Bajrami dhe Shqiperia” me nr. të Prokurimit: 613-23-4330-2-3-6.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti kontraktues Komuna e Lipjanit ka filluar procedurat e prokurimit për aktivitetin e prokurimit me titull “Perzgjedhja e nje kompanie gjeodezike te licencuar per matjen gjeodezike per rrugen Haradin Bajrami dhe Shqiperia” me nr. të Prokurimit: 613-23-4330-2-3-6.

RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 60

Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore.

Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0).

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit